



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0189

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së (OE) “Adnani Group Sh.P.K.” kundër Vendimit për anulim të aktivitetit të prokurimit të Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit : “Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve për klimatizim” me nr. të prokurimit: "VU644-23-7744-1-2- 1", me 02/05/2024, mori:

Vendim

- Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE “Adnani Group Sh.P.K.” me nr. 2024/189 , kurse vendimi i AK Komuna e Vushtrrisë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve per klimatizim” me nr. të prokurimit: "VU644-23-7744-1-2- 1", anulohet dhe lënda kthehet në Rivlerësim.
- Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
- Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 25/07/2023, Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve per klimatizim” me nr. të prokurimit: "VU644-23-7744-1-2- 1". Ndërsa me datën 20/02/2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku është anuluar

aktiviteti i prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 36,140 €.

Me 26/02/2024, "Adnani Group Sh.P.K." ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 28/02/2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 04/03/2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Komuna e Vushtrrisë me nr. 189/2024 për lidhur me aktivitetin "Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve për klimatizim" me nr. të prokurimit: "VU644-23-7744-1-2- 1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Adnani Group Sh.P.K." janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): "Me datën 20/02/2024 AK – Komuna Vushtrri ka publikuar njoftimin mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit dhe ka propozuar anulimin e procedurës në tërësi me arsyetimin se viti fiskal 2023 ka përfunduar, ndërsa përfundimi i projektit duhet të bartet në vitin fiskal 2024. Ky arsyetim i anulimit paraqet shkelje të dispozitave ligjore të LPP-se dhe ligjit mbi menaxhimin e financave publike. Në kohën kur e dorëzojmë këtë kërkesë për rishqyrtim, jeni në vitin 2024 dhe ju si AK për këtë procedurë të prokurimit bazuar në dispozitat ligjore, fillimisht jeni të obliguar që të ngarkoni disponueshmerinë e mjeteve të cilat ekzistojnë në platformën e prokurimit, të nënshkruar dhe konfirmuar nga ZKF, ZKA dhe ZPP të Autoritetit tuaj."

Pretendimi i dytë (II) : " Ju si Autoritet kontraktues - Komuna Vushtrri, me datën 02.10.2023, keni publikuar njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me procedurën e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve për klimatizim", me numër të prokurimit: VU 644-23- 7744-1-2-1, rrjedhimisht kompania tani ankuese "Adnani Group" Sh.P.K, është rekomanduar për dhënie të kontratës si oferte të përgjegjshme dhe me çmimin me të ulët, bazuar në kriteret e përcaktuara në dosjet e tenderit dhe në njoftim për kontratë. Përkundër faktit se vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit është nxjerre me datën 26.12.2023, përkatësisht tani me kaluar rreth 60 ditë kalendarike dhe ka kaluar çdo afat ligjor, ju si Autoritet Kontraktues – Komuna Vushtrri, tanimë thellohi me shkelje ligjore dhe tentoni të anashkaloni vendimin e organit të vetëm në Republikën e Kosovës, kompetent për të gjykuar dhe vendosur në raport me procedurat e prokurimit."

Pretendimi i tretë (III) : "Tentativa për anulim të procedurës së prokurimit me arsyetim të tillë dhe këtë fazë juve si AK, në procedurë eventuale në OSHP, mund të përgjigjeni për shkelje të

rende te Ligjit për Prokurim publik dhe ne si OE detyrohemi te kërkojmë zbatimin e nenit 28, pika 8, te iniciohet procedurë për revokimin e certifikatës. Bazuar ne piken K) te nenit 97, te Rregullores për Prokurim Publik, me nr. 001/2022, mosrespektimi i vendimit te Organit Shqyrtues te prokurimit konsiderohet si shkelje e rende e Ligjit për Prokurim Publik. Si shkelje e tille konsiderohet edhe tentativa për anulim te procedurës se prokurimit ne kundërshtim me nenin 62 te LPP-se. (shiko piken H, te nenit 97 te RPP-se, nr. 001/2022.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Adnani Group Sh.P.K.” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 25, 41, 52, 53, 62, 105, 130, 131, të LPP-së. Prandaj bazuar ne atë qe u përshkrua si me larte Operatori Ekonomik “Adnani Group” Sh.P.K - Podujeve, përmes kësaj kërkesë për rishqyrtim kërkon nga Autoriteti Kontraktues – Komuna Vushtrri, qe te ndërmerren veprime ligjore ne zbatim te Vendimit te Organit shqyrtues te Prokurimit, ku është lënë ne fuqi Vendimi i juaj, përkatësisht te nxjerrët ky: Vendim- Te aprovohet ne tërësi ankesa si e bazuar - Te anulohet njoftimi – Propozimi për anulim te aktiviteti te prokurimit - Te obligohet AK – Komuna Vushtrri qe te zbatohet vendimin e PSH-se me nr. 7/4 826/23. - Te shqiptohet Gjoke ndaj AK – Komuna Vushtrri për mos zbatim te vendimit me nr. 826/23 - Te lejohet kthimi i mjeteve te deponuara ne emër te ankesës. Ne si OE do t’i ndjekim te gjitha veprimet ligjore dhe do ti raportojmë shkeljet ligjore ne edhe ne organe tjera përveç OSHP-se.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: “Bazuar në të gjitha të cekurat si më lartë në këtë Vendim, A.K. vlerëson se pretendimet e Ankuesit të saktësuar në ankesën e tij janë të pabazuara, të pasakta dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së. Përfundimisht, A.K. vlerëson se me rastin e marrjes së vendimit si ai i dt. 20.02.2024 për të anuluar aktivitetin e prokurimit në fjalë nuk ka elemente apo prova se janë shkelur dispozitat e cituara si më lartë në këtë Vendim, me theks të veçantë neni 1 - Qëllimi, neni 7 - Barazia në trajtim/ Jo diskriminimi sepse nuk është vërtetuar se ndonjë O.E. është trajtuar Jo barabartë apo diskriminuar, nuk është vërtetuar se nuk ka pasur transparencë apo konkurrencë në mes O.E., neni 52 - Njoftimi i kriterëve të dhënies së kontratës dhe neni 59 par.4 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, andaj edhe pretendimet e Ankuesit lidhur me këto çështje, sikurse ka konstatuar dhe sqaruar A.K. përmes këtij Vendimi, janë të pabaza, jo të sakta dhe si të tilla janë hedhur poshtë. AK. në funde vjen në vlerësimin si dhe përfundimin e tij se asnjë nga pretendimet e O.E. : " Adnani Group "Sh.P.K. nuk qëndrojnë, pasi që të njëjtat nuk ka bazë ligjore, por janë të bazuara vetëm në vlerësime subjektive. A.K. ka marrë këtë vendim bazuar në elementin qenësor - thelbësor, mungesën e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të cilat eventualisht do të krijoheshin me nënshkrimin eventual të kontratës me OE. Ashtu sikurse është theksuar edhe më lartë, vazhdimi i mëtutjeshëm me këtë aktivitet të prokurimit, në mungesë të mjeteve financiare, natyrisht se do të përbënte shkelje ligjore, andaj sikurse ka vlerësuar Autoriteti Kontraktues, për të mos ndodhur një shkelje ligjore, dhe për të mos u dëmtuar si interesi i A.K. ashtu edhe interesi i OE, A.K. ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 12.03.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 189/2024, ndërsa me datë 22.03.2024 është dorëzuar

raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/189 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK. Nuk ka dhene përgjigje lidhur me rekomandimet e ekspertit shqyrtues ndërsa OE ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Adnani group SH.P.K.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/189 kanë vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: Kjo është ankesa e dytë e cila pranohet në OSHP për këtë aktivitet prokurimi. AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit, për të cilin janë ngritur disa pretendime nga OE ankues dhe për këto pretendime ka dhënë përgjigje eksperti si më poshtë.

Konstatimi i parë (I): “Eksperti shqyrtues sqaron se AK ka inicuar këtë aktivitet të prokurimit me datë 25/07/2023 dhe për të njëjtin aktivitet ka edhe një deklaratë të nevojave të nënshkruar nga ZKF dhe ZKA me të cilën deklarohet se ka mjete të disponueshme, të cilat janë të ndara enkas për zhvillimin e kësaj procedure. Pas disa muajsh përkatësisht pas rrjedhës së këtij aktiviteti dhe pranimit të një ankese në OSHP dhe nxjerrjes së vendimit nga paneli shqyrtues, procedurë e cila ka zgjatur deri në fund të vitit 2023, AK del me njoftim mbi vendimin për anulimin e kësaj procedure prokurimi pasi që nuk ka mjete të mjaftueshme për ta vazhduar më tutje, me arsyetimin se mjetet e parapara për vitin 2023 nuk janë paraparë edhe në vitin 2024. Sipas ekspertit veprimet e tilla nga ana e Autoriteteve janë shumë të gabuara, në momentin kur bëhet ndarja e mjeteve të caktuara dhe nënshkruhet një deklaratë e nevojave përmes të cilës vërtetohet disponueshmëria e mjeteve, do të thotë që këto mjete të ndara duhet të vlejnjë deri në finalizimin e asaj procedure, përkatësisht nëse kemi ndryshim të vitit fiskal, atëherë këto mjete duhet të barten për vitin tjetër dhe jo pa asnjë arsyetim konkret të ndryshohet destinimi i këtyre mjeteve, duke lënë procedurën e inicuar në gjysmë pa pasur mundësi të përfundimit të saj. Pra, kur AK inicion një aktivitet do të thotë se njësia kërkuese me të vërtetë ka nevojë për ato punë, shërbime apo furnizime dhe vendimet për anulim pamundësojnë plotësimin e këtyre nevojave. Duke marr parasysh situatën e krijuar, eksperti shqyrtues ka komunikuar me AK duke i kërkuar që të dërgoj

dëshmi për mos disponimin e mjeteve financiare e cila ka bërë që të vie deri tek anulimi i kësaj procedure. AK përmes e-mailit ka dërguar disa e-mail paraprak të komunikimit mes tyre dhe njësisë kërkuese si dhe ZKF ku të dy deklarojnë se nuk kanë mjete për të vazhduar më tutje këtë procedurë dhe se vazhdimi i kësaj procedurë do të bëjë AK të hyjë në obligime pa mbulesë. Email-at e dërguara (ku deklarohet se nuk ka mjete pa asnjë dëshmi konkrete) nuk janë bindëse për ekspertin, nga AK është kërkuar që të dërgoj edhe planifikimet buxhetore për vitin 2024 dhe as këto dëshmi nuk janë dërguar, po ashtu eksperti ka analizuar webfaqen e komunës për të parë nëse të njëjtat gjenden të publikuara për vitin 2024 por përsëri nuk ka asnjë të dhënë. Andaj, vetëm këto e-mail-a të dërguara, sipas ekspertit nuk mund të merren si dëshmi evidente për anulim të këtij aktiviteti. Marrë për bazë poashtu që anulimi nuk është bërë në përputhje me nenin 62 të Ligjit për Prokurimin Publik. Ky pretendim vlerësojmë që është i bazuar.”

Konstatimi i dytë (II) : “Paneli shqyrtues në vendimin e nxjerrë ka rekomanduar që të mbetet në fuqi Vendimi i AK-së, ku i rekomanduar për kontratë ka qenë ky OE ankues. Ky vendim është nxjerrë disa ditë para përfundimit të vitit 2023 dhe pas disa ditësh AK merr vendim për anulimin e procedurës së prokurimit me arsyetimin se nuk ka mjete financiare për këtë aktivitet. Pjesa tjetër e këtyre mjeteve është sqaruar nga eksperti në pretendimin e parë. Vlerësojmë që edhe ky pretendim është i bazuar.”

Konstatimi i tretë (III) : “Siç e kemi sqaruar edhe në pretendimin e parë, AK nuk ka vepruar në përputhje me nenin 62 të LPP-së kur ka anuluar këtë procedurë të prokurimit. Ky nen tregon qartë se kur një autoritet ka të drejtë të bëjë anulim të një aktiviteti dhe asnjëra nga arsyetimet e dhëna nuk është në përputhje me këtë nen. Po ashtu, AK nuk ka marrë parasysh as vendimin e panelit shqyrtues të cilët kanë kërkuar që Vendimi i AK-së të mbetet në fuqi, ku OE ankues tashmë ka qenë operator i rekomanduar. Edhe ky pretendim është i bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin “Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve për klimatizim” me nr. të prokurimit: "VU644-23-7744-1-2- 1". Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Adnani group SH.P.K.” dhe se, argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe komunikimeve të zhvilluara me autoritetin kontraktues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Adnani group SH.P.K.” janë të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar, lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve për klimatizim” me nr. të prokurimit:

"VU644-23-7744-1-2- 1", të anulohet njoftimi anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Në bazë të komunikimit të ekspertit shqyrtues, shihet qartë se autoriteti kontraktues nuk ka ofruar prova/dëshmi se nuk ka mjete për këtë aktivitet të prokurimit. Andaj, AK të veproj në raport me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Vlenë të theksohet se kjo lëndë është shqyrtuar edhe me herët nga OSHP për të cilën ka nxjerrë edhe vendim, për të cilën janë konsultuar edhe shkeljet e bëra nga autoriteti kontraktues.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

qKundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRRIË**
- **OE - Adnani group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: